



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 25.01.2021, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

-Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 2, 3, 4, 9 dhe 13 nëntor të vitit 2020.

2. Diskutimi dhe miratimi i projektkalendarit të punës së komisionit.
3. Njohja me korrespondencën drejtuar komisionit.

**Marrin pjesë:**

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

**Mungon:**

Enada Kapllani.

## HAPET MBLEDHJA

### **Ramazan Gjuzi - Përshëndetje!**

Ju uroj fillim të mbarë dhe kurorëzim të suksesshëm në veprimtarinë e komisionit në këtë sesion të fundit të kësaj legjislature!

Fillimisht verifikojmë prezencën e deputetëve në mbledhje.

Janë prezentë: Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova, Erion Piciri. Mungon Enada Kapllani, kurse z. Beqiraj i ka vdekur mamaja.

Atëherë, vazhdojmë me rendin e ditës. Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimi i procesverbaleve të datave 2, 3, 4, 9 dhe 13 nëntor të vitit 2020 dhe si pikë të dytë kemi diskutimin e projektkalendarit të punës së komisionit.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbaleve të datave 2, 3, 4, 9 dhe 13 nëntor të vitit 2020. Kush është dakord me procesverbalet? Kundër? Abstenim?

Miratohen.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, me diskutimin e projektkalendarit të punës së komisionit. Nga Kryesia propozohet të planifikohen çështjet e poshtëshënuara:

Seancë dëgjimore me zonjën Evis Kushi, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të raportuar në lidhje me ecurinë e procesit të eliminimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit 2019 në rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve mësimore në sistemin e arsimit parauniversitar, si dhe në sistemin e arsimit të lartë; po ashtu edhe për funksionimin i transportit të nxënësve dhe mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar.

Sekretaria jonë duhet të rakordohet me sekretarinë e Ministrisë së Arsimit që ministria e Arsimit të thërritet në seancë dëgjimore në datën më të përshtatshme që ka mundësi. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Sekretaria të marrë masat të njoftojë ministren dhe të caktojë datën e mbledhjes, për të cilën besoj se do të na njoftojnë brenda javës së ardhshme.

*Mbyllet pika e parë e rendit të ditës*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 25.01.2021, ora 10:10

**Drejton mbledhjen:**

**Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

2. Njohja me korrespondencën drejtuar komisionit.

**Marrin pjesë:**

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

**Mungon:**

Enada Kapllani.

***Vijon pika e dytë e rendit të ditës***

Pranë komisionit, siç jeni në dijeni, janë depozituar dy kërkesa: kërkesa e Universitetit të Tetovës drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, e cila nga Kryetari i Kuvendit i ka kaluar komisionit tonë, ku kërkohet që 22 nëntori, Dita e Alfabetit Shqip, të shpallet festë kombëtare edhe

në Republikën e Shqipërisë, edhe në Republikën e Kosovës. Ne jemi njohur me kërkesën, por paraprakisht do të marrim edhe mendimin e juristit për caktimin e datës.

Cili është mendimi juaj?

**Mirela Kumbaro** – Ne duhet të marrim mendimin e juristit për procedurat që duhen ndjekur dhe me cilin prej komisioneve duhet të rakordojmë për këtë gjë dhe, nëse e gjejmë në rregull me të gjithë kuadrin tjetër rregullator, të dalim si komision me një propozim, që më pas të shqyrtohet.

**Ramazan Gjuzi** – Dakord.

Kush është dakord me mendimin e zonjës Kumbaro?

Atëherë, juristi të koordinohet me Komisionin e Ligjeve dhe të na njoftojë.

Po ashtu na ka ardhur një kërkesë e Akademisë së Shkencave, në të cilën informon komisionin se Asambleja do të zhvillojë mbledhjen e saj vjetore në datën 29.01.2021, ora 11:00 në sallën “Aleks Buda” në prani të drejtpërdrejtë të anëtarëve të saj, në përputhje me kufizimet për shkak të pandemisë dhe në prani *online*.

Akademia thekson se pjesëmarrja në këtë mbledhje e përfaqësuesit të caktuar prej nesh në formën *online* është e mirëpritur. Në bashkëpunim me zonjën Kumbaro ne propozuam zotin Istmet Beqiraj. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

**Mirela Kumbaro** - Duhet lajmëruar zoti Beqiraj, meqenëse nuk është i pranishëm.

**Ramazan Gjuzi** – Është njoftuar, madje edhe unë sapo e njoftova dhe më tha që do të marr pjesë. Por tani edhe është prezent.

A keni pyetje?

**Mirela Kumbaro** – Kemi një proces të mbetur në mes lidhur me kandidaturat ose me vakancat e Këshillit Drejtues të RTSH-së. Unë mendoj që të marrim kontakt dhe po angazhohem ta bëj drejtpërdrejt, nëse ju jeni dakord, me Shërbimin e Monitorimit për t’i përditësuar kandidaturat, për të cilat, nëse ju kujtohet para pandemisë, nuk arritëm të procedonim me intervistat. Pra, të shikojmë ku jemi dhe t’i fusim edhe ata në kalendar, meqenëse e kemi si çështje të prapambetur nga mbledhjet e mëparshme, pra nga viti i kaluar. Unë mendoj se mund të procedojmë. Kandidaturat janë paraqitur, në dijeninë time. Të marrim një memo të plotë nga Shërbimi i Monitorimit, ta shqyrtojmë me kolegët e komisionit dhe, nëse jemi në rregull, të procedojmë me intervistat, nuk kemi pse i lëmë vendet vakant. Nuk na falet kjo vonesë, që ka

ndodhur edhe për shkaqe të tjera, por unë besoj se mund të ecim para me të. Pra, ta marrim këtë informacion dhe në mbledhjen më të afërt ta fusim në rendin e ditës.

**Ramazan Gjuzi** – Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mbledhja mbyllet.

Ju uroj punë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**